



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Lëvrimi vjeshtor-masë e rëndësishme agroteknike



Të nderuar Fermer

Lëvrimi vjeshtor është masë e rëndësishme dhe e nevojshme agroteknike për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore.

Për të pasur efekt të plotë pozitiv lëvrimi duhet të bëhet në kohën kur toka është në gjendje optimale për lëvrimë.

Koha optimale e tokës për lëvrimin vjeshtor është atëherë kur toka ka lagështi optimale.

Si mund ta konstatojmë në praktikë?

Nëse e marrim dheun me dorë dhe mund të formohet basi i cili gjatë hedhjes në tokë shpërndahet, toka ka sasi optimale të lagështisë dhe është koha e përshtatshme për lëvrim.

Në rast se nga dheu i marr në dorë nuk mund të formohet basi sepse toka nuk ka lagështi atëherë toka është e thatë.

Në rast se dheu ngjitet në dorë toka ka tepër lagështi për lëvrim.

Lëvrimi kur toka është thatë ose ka tepër lagështi sjell më shumë dëme se dobi.



Efektet pozitive të lëvrimin vjeshtor janë:

- Akumulimi i lagështisë në tokë.
- Rregullimi i strukturës së tokës

- Ajrosje më e mirë e tokës
- Përmirësimi i aktiviteteve mikrobiologjike të tokës
- Futë në thellësi e mbetjet e bimëve në sipërfaqe pas korrijeve, ku përmes zbërthimit të tyre shndërrohen në materie ushqyese për kulturat pasuese.

Pas lëvrimit vjeshtor preferohet mbyllja e brazdave me qëllim që të zvogëloj ekspozimin e sipërfaqes së lëvruar ndaj erës dhe diellit në mënyrë që të ruhet më mirë lagështia e tokës.

Gjatë periudhës dimërore në tokat e lëvruara akumulohet lagështia e cila shfrytëzohet nga bimët sidomos gjatë periudhës vegetative kur ka reshje të pakta.

Lëvrimi rregullon edhe shpërndarjen e plehut mineral në sipërfaqe, thellësinë e lëvrimit dhe shpërndahen më mirë në sipërfaqen e lëvruar.

Ju inkurajojmë të shfrytëzoni kohën e përshtatshme për lëvrimin vjeshtor ku do t'ju ndihmojë përgatitjen më të mirë të tokës për mbjellje dhe sigurimin e rendimenteve më të larta bujqësore.

Kush mund ofroj informata shtesë për nevojat tuaja?

Për këshilla dhe informata tjera të detajuara ju njoftojmë që mund të drejtoheni në Qendrat Informativ Këshilluese Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (QIKK), secili në komunën e vet tek këshilltarët komunal që janë pjesë e **Departamenti për Shërbime Këshilluese**.

Nëse keni nevojë për më shumë këshilla dhe informacione, mos ngurroni të kontaktoni me Këshilltarët tanë në Qendrat Këshilluese Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova

Tel. 383- (0)3820038426